

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 07.01.2016]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Hastoci” shpk (34%) dhe “Kajmaku” shpk (66%).

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor në rrugën IKV-Surrel dhe rrethrotullimi Shkozë”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor në rrugën IKV-Surrel dhe rrethrotullimi Shkozë”.**

Kohëzgjatja: Periudha e zbatimit të projektit do të jetë 4 muaj, periudha e mirëmbajtjes 18 muaj, gjithësej 22 muaj.

Fondi limit: **35.725.619 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 30.11.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH
1	I.S.P. P	25,371,496
2	SHQIPONJA-M	25,548,895
3	Al b G a r d e n	30,696,270
4	GJIKURIA	31,420,740
5	HASTOÇI	32,330,987
6	ALB-BUILDING	35,584,567

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm me arsyet përkatëse:

“I.S.P.P” shpk (80%) dhe “Agro Korani” shpk (20%) per arsye se:

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar dhe ne kete menyre nuk verteton se nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv), nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, dhe nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur Ekstraktin mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur asnje vertetim per realizim punesh te ngjashme.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ploteson numrin e nevojshem te punonjesve pasi sipas perqindjes (80%) i takon te kete mesatarisht 12 punonjes nderkohe qe per muajin janar ka 10 punonjes, shkurt 9, mars 9, prill 9, maj 9, qershor 11 dhe korrik 11. Per muajt gusht dhe shtator nuk ka paraqitur dokumenta.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon certifikaten ISO 39001 per menaxhimin e sigurise rrugore (Road Traffic Safety Management), leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon **ISO PAS 99** per sistemet e integruara te menaxhimit, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim.

Shoqeria “I.S.P.P” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon objekt mbeshtetes te specializuar per te magazinuar bimet (fidanishte), me kushte optimale te furnizimit me uje, pleherimit, ne menyre qe i gjithe materiali bimor te çertifikohet.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur vërtetim nga tatim taksat per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur asnje vertetim per realizim punesh te ngjashme.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se ka te punesuar te pakten nje agronom ose inxhinier pyjesh me eksperience pune te pakten 2 vjeçare.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon pikat e licenses se QKL II.4 per “Prodhim dhe tregtim i farerave dhe fidaneve” dhe licence me kod III.7.A per “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”.

Shoqeria “Agro Korani” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon ISO **14001:2004** mbi “Sistemet e menaxhimit te ambjentit”, certifikaten **OHSAS 18001-2007** per sistemin e drejtimit te shendetit dhe sigurise te punetoreve ne pune, **ISO 39001** per menaxhimin e sigurise rrugore (Road Traffic Safety Management) dhe **ISO PAS 99** per sistemet e integruara te menaxhimit.

“Shqiponja M” shpk (34.68%) dhe “Jon Alb Flora” shpk (65.32%) per arsye se:

Shoqeria “Jon Alb Flora” shpk nuk ka paraqitur Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9. Deklarata e paraqitur nga perfaqesuesi i shoqërisë “Shqiponja M” shpk nuk është firmosur nga perfaqesuesi i shoqërisë “Jon Alb Flora” shpk.

Shoqeria “Jon Alb Flora” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se disponon piken e licenses së QKL me kod III.7.A për “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”.

Shoqeria “Jon Alb Flora” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se disponon certifikatën **ISO 9001:2008** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësive”, **ISO 14001:2004** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, certifikatën **OHSAS 18001-2007** për sistemin e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë, **ISO 39001** për menaxhimin e sigurisë rrugore (Road Traffic Safety Management) dhe **ISO PAS 99** për sistemet e integruara të menaxhimit.

Shoqeria “Jon Alb Flora” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion (dokumentacionin e pronësive ose të qiramarrjes sic kërkohej në kërkesat për kualifikim) për të provuar se disponon objekt mbeshtetës të specializuar për të magazinuar bimë (fidanishte), me kushte optimale të furnizimit me ujë, pleherimit, në mënyrë që të gjithë materialit bimor të çertifikohej. Ka paraqitur një deklaratë për disponimin e një sipërfaqe në qytetin e Vlores, por nuk ka paraqitur asnjë dokument pronësie apo qeramarrje.

Shoqeria “Shqiponja M” shpk nuk plotëson kërkesën për gjendjen e likuiditeteve në bankë, pasi vertetimi i paraqitur është leshuar në emër të “Shqiponja M” shpk & “NOA Development” nënkohë që shoqëria “NOA Development” nuk merr pjesë në këtë procedurë prokurimi.

“Alb Garden” shpk për arsye se:

Nuk plotëson kërkesën për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Janar 2015-Shtator 2015 të jetë mesatarisht jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës në muaj. Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues. Kjo të dëshmohej me vertetim nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar dhe të shoqërohet me formularin E-SIG” pasi të gjithë punëtorët që ka deklaruar janë të angazhuar në kontratën e lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt: **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Lot 2”**, dhe kjo kontratë është ende në proces zbatimi.

Nuk plotëson kërkesën për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij të paktën një agronom ose inxhinier pyjesh me eksperience pune të paktën 2 vjeçare. Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe cv përkatëse” pasi të dy inxhinierët (ing agronom Kol Kola dhe ing pyjeve Edi Trashaj) janë të angazhuar në kontratën e lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt: **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Lot 2”**, dhe kjo kontratë është ende në proces zbatimi.

Nuk plotëson kërkesën për kualifikim “Operatori ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008” Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit,

klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme: N.P – 12. “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. Licensa që kjo shoqëri zoteron është e kategorisë “A” e cila lejon shoqërinë të kryejë punime me vlerë deri 20.000.000 leke. Vlera e punimeve që prokurohen është më e madhe se 20.000.000 leke. Ky fakt është në kundërshtim me Rregulloren “Për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, konkretisht me Kreun III, pikë II, germa “b” të kësaj rregulloreje.

“Gjikuria” shpk (80%) dhe “Green Farm” shpk (20%) për arsye se:

Shoqëria “Gjikuria” shpk nuk plotëson kushtin për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit të tenderit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e fondit limit të tenderit” pasi vlera e punëve të ngjashme të deklaruara është 17.691.968 leke, ndërkohë që si shoqëria me përqindjen më të madhe në bashkim duhet të paraqiste punë me vlerë jo më të vogël se 17.862.809 leke.

Kamioni me targë AA590LJ në pronësi të shoqërisë “Green Farm” shpk është i angazhuar në kontratën e lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe hyrje-dalje në qendrat e banuara në segmentin Levan – Kakavijë”, dhe kjo kontratë është ende në proces zbatimi. Shoqëria “Green Farm” shpk nuk plotëson kushtin për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij të paktën një agronom ose inxhinier pyjesh me eksperiencë punë të paktën 2 vjeçare. Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe cv përkatëse” pasi agronomi Dhimiter Qorri është i angazhuar në kontratën “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe hyrje-dalje në qendrat e banuara në segmentin Levan – Kakavijë”, dhe kjo kontratë është ende në proces zbatimi.

Shoqëria “Green Farm” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se disponon certifikatën **ISO 39001** për menaxhimin e sigurisë rrugore (Road Traffic Safety Management) dhe **ISO PAS 99** për sistemet e integruara të menaxhimit.

“Alb Building” shpk (70%) dhe “Kaleshi” shpk (30%) për arsye se:

Bashkimi i shoqërive nuk është bërë në përputhje me nenin 74, pikë 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ku ndër të tjera citohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”. Në marrëveshjen e lidhur para noterit është përcaktuar vetëm përqindja e pjesëmarrjes për secilin shoqëri dhe nuk janë përcaktuar elementet konkrete të punës që do të kryejë secili nga anëtarët e bashkimit. Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se secila shoqëri do të marrë pjesë në zbatimin e secilit prej të punimeve në përputhje me përqindjen e punimeve që kanë marrë pjesë. Në këtë mënyrë secila shoqëri duhet të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim sipas përqindjes që i takon.

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk ploteson kushtin per kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit te tenderit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e fondit limit te tenderit” pasi per punen e deklaruar (si nenkontraktor) nuk ka paraqitur faturat tatimore te leshuara nga shoqeria “Alb Building” shpk qe vertetojne kryerjen e punes.

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk disponon Liçense me kod II.4 per “Prodhim dhe tregtim i farerave dhe fidaneve” dhe Licence me kod III.7.A per “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”, leshuar nga QKL.

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk ploteson kushtin per kualifikim per disponimin e mjeteve dhe paisjeve te nevojshme teknike pasi asnje prej kamioneve te paraqitur nuk ka kapacitet mbajtes 20 ton, sic kerkohet ne kerkesat per kualifikim.

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion (dokumentacionin e pronesise ose te qiramarrjes sic kerkohet ne kerkesat per kualifikim) per te provuar se disponon objekt mbeshtetes te specializuar per te magazinuar bimet (fidanishte), me kushte optimale te furnizimit me uje, pleherimit, ne menyre qe i gjithe materiali bimor te çertifikohe.

Shoqeria “Kaleshi” shpk nuk disponon piken NP-12 te licenses, kerkuar ne kerkesat per kualifikim, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje 30% te punimeve.

Shoqeria “Kaleshi” shpk nuk ploteson kushtin per kualifikim per disponimin e mjeteve dhe paisjeve te nevojshme teknike pasi pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin vetem te nje korrese bari, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje 30% te punimeve.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Hastoci” shpk (34%) dhe “Kajmaku” shpk (66%)** se oferta e paraqitur, me vlerë 32.330.987 (tridhjetë e dy milion e treqind e tridhjetë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e shtate) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10.12.2015**.

Per vleresimin ne daten 16.12.2015 paraqiti ankim shoqeria “AlbGarden” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 24.12.2015 duke e refuzuar ate. Ankesa te tjera nuk ka patur